



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Korçë, më datë 30/11/2023

Proces-verbal

Bazuar në ligjin nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 16 nëntor 2023 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të banorëve u zhvilluan takime me banorët e Rajonit 1, 2 dhe 3 të qytetit të Korçës.

Për shkak se gjatë këtij takimi një nga qytetarët pjesëmarrës pësoi arrest kardiak (ngjarje e cila çoi në mbyllje të takimit, Paketa Fiskale 2024 nuk u diskutua.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, Kletjon Kita Zv.Kryetar Bashkia Korçë, Ilir Dinellari Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Leonard Gjançi Drejtor i Menaxhimit të Kontratave, Soniel Prifti Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara dhe në proces në qytetin e Korçës. Mes tyre përmendi termoizolimin e pallateve të ndërtuara para viteve '90, Gazifikimin e Korçës, një tjetër projekt madhor që do të fillojë shumë shpejt. Për të vijuar më pas me ndërtimin e stadiumit “Skënderbeu”, si edhe ndërtimin e Polit të Jugut qendrës më të madhe për zhvillimin e eventeve, panairëve dhe jetës së natës. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të qytetarëve dhe vendosjen e prioriteteve për investimet, pasi impakti i parë i çdo projekti perceptohet prej tyre.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje”, qytetarët e Korçës patën hapësirën e nevojshme kohore për të ngritur kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2024. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara.

Bazuar në kërkesat e ngritura nga qytetarët u listuan prioritetet si më poshtë:

1. Termoizolimi i pallateve të para viteve '90
2. Asfaltimi i disa rrugëve brenda zonave të banimit
3. Krijimi i hapësirave të reja çlodhëse mes pallateve

XXX: Banor, lagjja 10: Ju falenderojmë që na bëni pjesë të këtyre takimeve. Është shumë e rëndësishme të ndajmë së bashku ato shqetësime që kemi në lidhje me zonën ose lagjen ku banojmë. Pjesa më e madhe e pallateve të lagjes 10 ka nevojë për ndërhyrje nga ana e bashkise, nese është e mundur, për sistemimin e ambienteve të përbashkëta dhe tarracës.

XXX: Banor, lagjja 17: Për Korçën si një qytet i ftohtë termoizolimi do të ishte zgjidhja më e mirë për periudhën e dimrit dhe për të ulur shpenzimet për ngrohje. Ndaj ju lutemi ta shihni me përparësi këtë premtim nga ana juaj me qëllim që termoizolimi të shtrihet në të gjithë qytetin. Një tjetër shqetësim për banorët e Rrugës “Ajet Gjindolli” janë kanalizimet e ujërave të zeza të konviktit të ish- shkollës Bujqësore. Rrjeti i kanalizimeve ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme. Po ashtu në këtë zonë duhen të kryhen kontrole më të shpeshta nga ana e policisë bashkiake pasi ka shumë njerëz që ndotin ambientin duke ndezur zjarre me goma. Ju urojmë punë të mbarë në vazhdim.

XXX: Banor, lagjja 1: Një problematikë që ngremë si banor të lagjes 1 është këndi sportiv dhe i gjimnastikës tek parku “Rinia”, i cili duhet të zgjerohet më shumë, sepse ka një frekuentueshmëri të lartë.

XXX: Banor, lagjja 4: Keni bërë një punë shumë të mirë për shtimin e hapësirave të gjelbra në qytet, por e shoh si të domosdoshme ndërtimin e ambienteve të reja çlodhëse në blloqet mes pallateve të lagjes 4 , si edhe mirëmbajtjen e lulishteve ekzistuese, pasi në pjesën më të madhe të tyre janë të pushtuara nga ferrat dhe barërat e këqinj. Faleminderit!

XXX: Banor. Pallati 18 tek ish-Gjeologjiku është në gjendje shumë të keqe dhe ka nevojë emergjente për termoizolim. Është një kërkesë e të gjithë banorëve, duam që ta shihni me përparësi si problematikë dhe t’i jepni zgjidhje sa më parë.

XXX: Banor, Rruga e Kolonjës: Për ne si banorë të lagjeve periferike që vijnë të jenë sërish lagje informale, do të ishte e domosdoshme që bashkia të planifikonte investime në infrastrukturë. Pasi të gjitha rrugët në këto lagje janë të pa asfaltuara

XXX: Banor, lagjja 15: Një problem tjetër janë edhe këndet e lojërave për fëmijë, të cilat duhet të përmirësohen kudo në qytet, duhet të zëvendësohen lodrat e vjetra me të reja, si edhe duhet të shikohet mundësia për ndonjë sistemim.

